



HEKURUDHAT E KOSOVËS - TRAINKOS SH.A

RREGULLORE

**MBI PLOTËSIMIN E KUSHTEVE SHËNDETËSORE TË PUNONJËSVE
TË HEKURUDHAVE TË KOSOVËS - TRAINKOS SH.A.**

Fushë Kosovë

Tetor 2024

Në bazë të Nenit 20 të Ligjit 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, nenit 26.23 të Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Koorporative për NP dhe në bazë të Ligjit 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, Bordi i Drejtorëve i Hekurudhave të Kosovës - Trainkos Sh.A., në Mbledhjen Nr. 13, të mbajtur më 30.10.2024, miraton këtë:

RREGULLORE MBI PLOTËSIMIN E KUSHTEVE SHËNDETËSORE TË PUNONJËSVE

KREU I

DISPOZITAT THEMELORE

Neni 1

Qëllimi

Me këtë rregullore parashihet mënyra e përcaktimit të kushteve të veçanta shëndetësore, forma dhe koha e konstatimit dhe verifikimit të aftësisë shëndetësore të punonjësve të Hekurudhave të Kosovës-Trainkos Sh.A., të cilët drejtpërdrejtë marrin pjesë në organizimin e komunikacionit hekurudhor.

Neni 2

Fushëveprimi

2.1. Punonjësit e Hekurudhave të Kosovës –Trainkos Sh.A. në punët e caktuara, të cilët marrin pjesë në organizimin e komunikacionit hekurudhor (në tekstin në vijim: punonjësit e Trainkos Sh.A.), në aspektin shëndetësor duhet të jenë të aftë për kryerjen e këtyre punëve.

2.1. Punonjësit nga paragrafi 1 i këtij neni, konsiderohen të aftë, në aspektin shëndetësor, nëse plotësojnë kushtet e veçanta shëndetësore të parashikuara me këtë rregullore.

2.1. Kushtet e veçanta shëndetësore të punonjësit përcaktohen me kontrollimin paraprak shëndetësor, ndërsa verifikimi i aftësisë shëndetësore gjatë punës kryhet në afate periodike (kohore) dhe kontrollim të jashtëzakonshëm shëndetësor.

Neni 3

3.1. Përcaktimin e kushteve të veçanta shëndetësore dhe verifikimin e aftësisë shëndetësore të punonjësve të Hekurudhave të Kosovës-Trainkos Sh.A., e kryen institucioni i specializuar i shëndetësisë, i cili ka kuadrin adekuat, pajisjet dhe kushtet tjera, njeh procesin dhe kushtet e punës të punonjësve të hekurudhës për të konstatuar aftësinë shëndetësore të tyre.

3.2. Personi përgjegjës i Ndërmarrjes Trainkos Sh.A., (projekt-menaxheri) ka të drejtën që nga institucioni shëndetësor të marrë raport të detajuar mbi ecurinë e trajtimit të punëtorit gjatë periudhës sa gjendet në paaftësinë e tij. (si përfillja e rekomandimeve të institucionit shëndetësor nga punëtori mbi trajtimin e gjendjes së tij shëndetësore etj.).

3.3. Personi përgjegjës i Ndërmarrjes Trainkos Sh.A., (projekt-menaxheri) ka për obligim të

njoftojë përgjegjësën e parë të punëtorit (dhe hierarkinë përkatëse) me të marrë raportin mjekësor nga institucioni shëndetësor.

Neni 4

4.1. Varësisht nga shkalla e pjesëmarrjes në organizimin e punëve me rëndësi për sigurinë e komunikacionit hekurudhor, punonjësit e Trainkos Sh.A., të cilët drejtpërdrejtë marrin pjesë në organizimin e komunikacionit hekurudhor, në bazë të profesioneve sistemohen në tri kategori:

Kategoria I

- a) Makinist;
- b) Frenues-Manovrues.

Kategoria II

- a) Kontrollues i vagonëve;
- b) Udhëheqës treni-ndihmës makinist;
- c) Ndërrues në tërheqjen e trenave;
- d) Ndihmës makinist.

Kategoria III

- a) Mbikëqyrës i mjeteve tërheqëse;
- b) Konduktor;
- c) Instruktor i tërheqjes.

Neni 5

Përcaktimi i kushteve të veçanta shëndetësore dhe verifikimi i aftësive shëndetësore të punonjësve të Trainkos Sh.A., kryhet në bazë të gjendjes së përgjithshme shëndetësore, aftësisë psikike, gjendjes së dëgjimit, gjendjes së shikimit dhe njohjes së ngjyrave.

Neni 6

6.1. Nëse gjatë kontrollimit paraprak periodik (kohor) ose kontrollimit të jashtëzakonshëm shëndetësor konstatohet se punonjësi i Trainkos Sh.A., nuk i plotëson kushtet e veçanta shëndetësore ose konstatohet sëmundja apo kundër-indikacionet e parashikuara, me këtë rregullore konsiderohet i paaftë në aspektin shëndetësor në kryerjen e punëve të kategorisë së caktuar, përderisa zgjatë kjo paaftësi.

6.2. Për zgjatjen e paaftësisë shëndetësore të punonjësit të HK-Trainkos Sh.A., sipas kuptimit të paragrafit 1 të këtij neni, vendos institucioni i specializuar i shëndetësisë, i cili e ka konstatuar paaftësinë shëndetësore.

KREU II

KUSHTET E VEÇANTA SHËDETËSORE

Neni 7

7.1. Kushtet e veçanta shëndetësore përcaktohen me kontrollimin paraprak shëndetësor i cili kryhet:

- a). Para themelimit të marrëdhënies së punës, gjegjësisht para sistemimit të punonjësit të HK-Trainkos Sh.A., në punët e parashikuara sipas nenit 4 të kësaj Rregulloreje;
- b). Para dërgimit të punonjësit në shkollim ose në aftësimin profesional për kryerjen e punëve të parashikuara sipas nenit 4 të kësaj Rregulloreje.

7.2. Dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni, kanë të bëjnë edhe me punonjësit të cilët përkohësisht caktohen në njërin prej punëve të parashikuara në nenin 4 të kësaj Rregulloreje.

Neni 8

Punonjësit e Trainkos Sh.A. gjatë kontrollimit shëndetësor sistemohen në tri kategori shëndetësore, edhe atë:

- Sipas kategorisë së punëve në të cilën janë sistemuar;
- Në bazë të kushteve të veçanta shëndetësore; si dhe
- Në bazë të kryerjes së punëve të caktuara.

Neni 9

9.1. Në aspektin e gjendjes së përgjithshme shëndetësore, punonjësit e Trainkos Sh.A., sistemohen në këto grupe shëndetësore:

9.1.1. Në grupin e parë shëndetësor përfshihen punonjësit të cilëve gjendja e tyre shëndetësore u mundëson kryerjen e punëve të caktuara pa rrezik për komunikacionin hekurudhor dhe nëse nuk ekzistojnë kundër-indikacionet e parashikuara me këtë rregullore.

Nuk duhet të kenë ndonjë sëmundje ose të jenë në përdorim të ndonjë ilaçi apo medikamenti ose substanca të cilat kanë të ngjarë të shkaktojnë:

- a). Humbje të papritur të vetëdijes;
- b). Reduktimin e vëmendjes apo pamundësi të përqendrimit;
- c). Paaftësi të papritur;
- d) Humbje të drejtpeshimit apo koordinimit;
- f) Kufizim të rëndësishëm në lëvizshmëri.

9.1.2. Në grupin e dytë shëndetësor përfshihen punonjësit, sëmundja e të cilëve, marrë parasysh edhe kundër-indikacionet, nuk zvogëlon aftësinë funksionale të organizmit si dhe punonjësit te

të cilët janë paraqitur ndryshime në gjendjen e tyre shëndetësore nëse ato nuk ndikojnë në aftësinë shëndetësore të punonjësit e cila është me rëndësi për sigurinë e komunikacionit hekurudhor.

9.1.3. Në grupin e tretë shëndetësor përfshihen punonjësit të cilët është konstatuar se lëngojnë nga sëmundjet duke i marrë parasysh edhe kundër-indikacionet, të cilat në shkallë të madhe zvogëlojnë aftësitë funksionale të organizmit, por dukshëm nuk ndikojnë në aftësinë shëndetësore të punonjësit e cila është me rëndësi për sigurinë e komunikacionit hekurudhor.

Neni 10

Në aspektin e shikimit, dëgjimit dhe të folurit për punonjësit e Trainkos Sh.A., duhet të plotësojnë këto kritere:

Në grupin e parë shëndetësor

10.1. Shikimi-kërkesat e mëposhtme sa i përket shikimit duhet të jenë në pajtueshmëri me:

- a) Aftësinë e shikimit në distancë e ndihmuar ose jo 1.0; dhe minimum 0.5 për syrin më të dobët;
- b) Thjerrëzat korigjuese maksimale: hypermetropia +5/miopia -8. Përrjashtimet janë të autorizuar në raste të jashtëzakonshme dhe pasi të kenë marrë mendimin e një specialisti të syve, mjeku pastaj merr vendimin;
- c) Shikimin e afërt dhe të mesëm: mjaftueshëm i ndihmuar ose jo;
- d) Thjerrëzat e kontaktit dhe syzet janë të autorizuar kur kontrollohen periodikisht nga një specialist;
- e) Shikimin normal të ngjyrave: përdorimi i një testi të njohur, i tillë si Ishihara, si dhe një tjetër test të njohur nëse kërkohet;
- f) Fusha e shikimit: e plotë;
- g) Shikimin për të dy sytë: efektiv; nuk kërkohet kur personi ka përshtatje adekuate dhe eksperiencë të mjaftueshme. Vetëm në rast se ai ka humbur shikimin binokular pasi ka filluar punën;
- h) Shikimin me të dy sytë: efektiv;
- i) Njohjen e sinjaleve me ngjyra: testi duhet të jetë i bazuar në njohjen e ngjyrave dhe jo mbi dallimet relative;
- j) Ndjeshmërinë ndaj kontrasteve: të mirë;
- k) Nuk ka sëmundje progresive të syve;
- l) Implantet lentet, karatotomies dhe karatectomies janë të lejuara vetëm me kusht që

- ato janë të kontrolluara në baza vjetore ose në interval të përcaktuar nga mjeku;
- m) Aftësi për t'i bërë ballë shkëlqimeve verbuese;
 - n) Thjerrëzat e kontaktit me ngjyra dhe thjerrëzat photochromatic nuk janë të lejuara. Thjerrëzat UV janë të lejuara.

10.2. Kërkesat e të dëgjuarit dhe të folurit:

- a) Dëgjim i mjaftueshëm i konfirmuar nga audiogrami, p.sh. dëgjim i mjaftueshëm për bisedë telefonike, si dhe të jetë në gjendje të dëgjojë tinguj dhe mesazhe paralajmëruese në radio;
- b) Mungesa e dëgjimit nuk duhet të jetë më e lartë se 40 dB në 500 dhe 1 000 Hz;
- c) Mungesa e dëgjimit nuk duhet të jetë më e lartë se 45 dB në 2000 Hz për veshin jo të mirë në të dëgjuarit e zërit;
- d) Nuk lejohen anomali në sistemin vestibular;
- e) Nuk lejohen çrregullime kronike në të folur (duke pasur parasysh nevojën për të shkëmbyer mesazhe me zë të lartë dhe qartë);
- f) Përdorimi i mjeteve ndihmëse për të dëgjuar është i lejuar vetëm në raste të veçanta.

Në grupin e dytë shëndetësor

10.3. Shikimi - kërkesat e mëposhtme sa i përket shikimit duhet të jenë në pajtueshmëri me:

- a) Aftësinë e shikimit në distancë e ndihmuar ose jo 1.0; dhe minimum 0.5 për syrin më të dobët;
- b) Thjerrëza korigjuese maksimale: hypermetropia +5/miopia -8. Përrjashtimet janë të autorizuara në raste të jashtëzakonshme dhe pasi të kenë marrë mendimin e një specialisti të syve. Mjeku pastaj merr vendimin;
- c) Shikimin e afërt dhe të mesëm: mjaftueshëm i ndihmuar ose jo;
- d) Thjerrëzat e kontaktit dhe syzet janë të autorizuara kur kontrollohen periodikisht nga një specialist;
- e) Shikimi normal i ngjyrave: përdorimi i një testi të njohur, i tillë si Ishihara, si dhe një tjetër test të njohur nëse kërkohet;
- f) Fusha e shikimit: e plotë;
- g) Shikimi për të dy sytë: efektiv; nuk kërkohet kur personi ka përshtatje adekuate dhe eksperiencë të mjaftueshme. Vetëm në raste se ai ka humbur shikimin binocular pasi ka filluar punën;
- h) Shikimi me të dy sytë: efektiv;

- i) Njohja e sinjaleve me ngjyra: testi duhet të jetë i bazuar në njohjen e ngjyrave dhe jo mbi dallimet relative;
- j) Ndjeshmërinë ndaj kontrasteve: të mirë;
- k) Nuk ka sëmundje progresive të syve;
- l) Implantet lente, karatomes dhe karatektomies janë të lejuara vetëm me kusht që ato janë të kontrolluara në baza vjetore ose në interval të përcaktuar nga mjeku;
- m) Aftësi për t'i bërë ballë shkëlqimeve verbuese;
- n) Thjerrëzat e kontaktit me ngjyra dhe thjerrëzat photochromatic nuk janë të lejuara, thjerrëzat UV janë të lejuara.

10.4. Kërkesat e të dëgjuarit dhe të folurit

- a) Dëgjim i mjaftueshëm i konfirmuar nga audiogrami, p.sh. dëgjim i mjaftueshëm për bisedë telefonike, si dhe të jetë në gjendje të dëgjojë tinguj dhe mesazhe paralajmëruese në radio;
- b) Mungesa e dëgjimit nuk duhet të jetë më e lartë se 40 dB në 500 dhe 1 000 Hz;
- c) Mungesa e dëgjimit nuk duhet të jetë më e lartë se 45 dB në 2000 Hz për veshin jo të mirë në të dëgjuarit e zërit;
- d) Nuk lejohen anomali në sistemin vestibular;
- e) Nuk lejohen çrregullime kronike në të folur (duke pasur parasysh nevojën për të shkëmbyer mesazhe me zë të lartë dhe qartë);
- f) Përdorimi i mjeteve ndihmëse për të dëgjuar është i lejuar vetëm në raste të veçanta.

Në grupin e tretë shëndetësor

Nëse është konstatuar mprehtësia e shikimit në sy me të cilin sheh më mirë 1.5 e në syrin me të cilin sheh dobët 1.0 pa korrektime, me që ekziston mundësia e kryerjes së korrektimit veçmas në secilin sy deri në 0.7, thjerrëzat korigjuese maksimale: hypermetropia +6/ myopia -9, te të cilët ekziston shikimi binokular, fusha normale e shikimit dhe shtypja normale intraokulare dhe të cilit në aspektin e njohjes të ngjyrave nuk janë anob.

Neni 11

Përcaktimi i aftësisë për njohjen e ngjyrave kryhet me metodën e ishiharit ose të stillingut. Në rastet e paqarta, përcaktimi i aftësisë për njohjen e ngjyrave kryhet sipas metodës së Frasnworthit D-15 ose me anomaloskopi, me ç'rast si normale konsiderohen vlerat AQ prej 0.7 deri në 1.3. përcaktimi i aftësisë, adaptimi në errësirë, kryhet me skotoptikometer no Nein sius – U ose me ndonjë instrument tjetër për ekzaminimin- testimin primar.

Kreu III

PËRCAKTIMI I KUSHTEVE TË VEÇANTA SHËNDETËSORE TË KONTROLLIMIT PARAPRAK SHËNDETËSOR

Neni 12

Punonjësi i Trainkos Sh.A., i cili kryen punët e kategorisë së parë, gjatë kontrollimit shëndetësor paraprak në aspektin e gjendjes së përgjithshme shëndetësore, gjendjes së dëgjimit, shikimit dhe njohjes së ngjyrave, duhet t'i plotësojë kushtet e grupit të parë shëndetësor.

Neni 13

13.1 Punonjësit e Trainkos Sh.A., të cilët kryejnë punët e kategorisë së dytë gjatë kontrollimit shëndetësorë paraprak duhet t'i plotësojë këto kushte:

- a). Në aspektin e gjendjes së përgjithshme shëndetësore - kushtet e grupit të parë shëndetësor;
- b). Në aspektin e gjendjes së dëgjimit - kushtet e grupit të parë shëndetësor;
- c). Në aspektin e gjendjes së shikimit dhe njohjes së ngjyrave – kushtet e grupit të parë shëndetësor.

Neni 14

Punonjësi i Trainkos Sh.A., i cili kryen punët e kategorisë së tretë gjatë kontrollimit paraprak shëndetësor në aspektin e gjendjes së përgjithshme shëndetësore, gjendjes së dëgjimit dhe shikimit me njohjen e ngjyrave, duhet t'i plotësojë kushtet shëndetësore të grupit të tretë shëndetësorë.

KREU IV
KUNDËRINDIKACIONET PËR PUNËT NË TË CILAT PUNONJËSIT E TRAINKOS
SH.A. MARRIN PJESË DREJTPËRDREJTË NË ORGANIZIMIN E
KOMUNIKACIONIT HEKURUDHOR

Neni 15

15.1. Kundërindikacionet për punët në të cilat punonjësi i hekurudhës drejtpërdrejtë merr pjesë në organizimin e komunikacionit hekurudhor, në aspektin e gjendjes së përgjithshme shëndetësore janë:

15.1.1. Gjendja dhe sëmundjet psikiatrike dhe neurologjike

- a) Psikoza;
- b) Neuroza;
- c) Çrregullimet personale;
- d) Alkoolizmi, narkomania;
- e) Prapambeturi shpirtërore;
- f) Traumata, ndezjet dhe sëmundjet vaskulare të sistemit nervor qendror me pasoja të përhershme;
- g) Sëmundjet trashëguese, proceset multikulare, sindromet ekstrapiramidale, atakimet dhe sëmundjet e neuroneve motorike;
- h) Miopati;
- i) Epilepsia dhe dyshimi në epilepsi;
- j) Sindromi i dhimbjes me prejardhje vertebrale me çrregullime të rënda funksionale;
- k) Sëmundja periferike nervore me çrregullime të rënda funksionale.

15.1.2 Gjendja psikike

- a) Deficiti mental;
- b) Çrregullimi i memories;
- c) Çrregullimi i kujdesit;
- d) Pengesat psikomotorike;
- e) Labiliti emocional.

15.1.3 Gjendja dhe sëmundjet e zemrës dhe enëve të gjakut (sistemi kardiovaskular)

- a) Rastet e rënda të sëmundjes së enëve të gjakut dhe zemrës;
- b) Gjendja pas infarkt të miokardit;
- c) Sëmundjet e zemrës të cilat mund të shkaktojnë ndërrimin e ritmit dhe gjendjen e shfaqjes së simptomave (sinkopa);
- d) Çrregullimet e lindura dhe të trashëguara me shenja të dekompsimit;
- e) Lindja dhe trashëgimi i sëmundjeve të enëve të mëdha të gjakut;

- f) Blloku komplet i zemrës dhe blloku AV I shkallës së II;
- g) Blloku i anës së majtë i tufës së His-it;
- h) Sëmundjet kronike të zemrës;
- i) Gjendja pas perikardit me shenja të opstruksionit;
- j) Sëmundja hipertonsike me shtypje diastolike mbi 100 mm Hg ose me shenja të dëmtimit të Enëve të gjakut të syrit, zemrës ose veshkave.

15.1.4 Gjendja e sëmundjeve të sistemit respirator

- a) Sëmundja e sistemit respirator e cila shkakton infeksionin respirator ose të zemrës;
- b) Mushkëritë me tuberkuloz aktiv;

15.1.5 Sëmundja e rëndë e mëlçisë ose veshkave.

15.1.6 Sëmundjet e sistemit endokrinar

- a) Diabeti mellitus;
- b) Forma e rëndë e hipertirozës ose hipertiroza;
- c) Hiper-ose hipoadenokortcizmi në shkallë të shprehur.

15.1.7 Sëmundjet e sistemit të gjakut

- a) Hemotapija malinje;
- b) Anemia e shkallës së rëndë dhe sindroma hemorragjike.

15.1.8 Format e rënda të sëmundjes së lëkurës

15.1.9 Gjendja, sëmundjet dhe lëndimet e aparatit lokomotorik, nëse pamundësojnë kryerjen e punëve me rëndësi për sigurinë në komunikacionin hekurudhor.

Neni 16

16.1 Kundër indikacionet në aspektin e dëgjimit janë:

- a) Dëmtimet në të dy anët e veshit (labirintit) që shkakton çrregullimin e drejtpeshimit,
- b) Sëmundjet malinje të qafës, sinuset, epifarkasit, mezofapinaksit dhe hipofarikasit, gjuha, larinasi, gjëndrat mbrojtëse dhe gjëndrat e pështymës;
- c) Paraliza e nepsit të butë, farinkasit, larinkasit, stenozet e ezofagusit, larina dhe traheja;
- d) Otokleroza;
- e) Qelbja në një ose të dy anët dhe ndezja e veshit të mesëm me ose pa mastoiditis;
- f) Forma ozenesme rëndë;
- g) Polipoza e zgavrave të hundës dhe e sinuseve;
- h) Çrregullimet e mëdha gjatë foljes.

Neni 17

17.1 Kundër indikacionet në aspektin e shikimit janë:

- a) Mjegullimi i madh i bebëzës;
- b) Ptoza e kapakëve të syrit në skajet e kapakëve, mbërrijnë deri në gjysmën e bebëzës;
- c) Strabizmi me kënd të madh;
- d) Glaucoma;
- e) Abolimi i retinës;
- f) Pareza ose paraliza e nervave të syrit;
- g) Sëmundja e retinës dhe nervit shikues;
- h) Katarakta;
- i) Afakia e cila nuk mund të korrigjohet me thjerrëzat kontraktuese;
- j) Skotomet objektive ose absolute;
- k) Anofatolmushi (monokul);
- l) Astigmatizmi i përzier mbi 2.0 d;
- m) Mosnjohja e ngjyrave.

KREU V

VERIFIKIMI I GJENDJES SHËNDETËSORE

Neni 18

Verifikimi i aftësisë shëndetësore të punonjësve të Trainkos Sh.A. kryhet në periudha kohore (periodike) dhe kontrollimin e jashtëzakonshëm shëndetësor.

18.1. Përmbajtja minimale e ekzaminimit përpara emërimit/përzgjedhjes

- a) Ekzaminimi mjekësor;
- b) Ekzaminimi mjekësor i përgjithshëm;
- c) Ekzaminimi i funksioneve shqisore (shikimi, dëgjimi, perceptimi i ngjyrave);
- d) Analizat e gjakut ose urinës, mes tjerash për diabet sheqeri (mellitus) për sa kohë ato janë të nevojshme për të gjykuar aftësinë fizike të kandidatit;
- e) Testin e Elektrokardiogram (EKG);
- f) Testin për substanca psikotrope (psychotropic substances) të tilla si droga të paligjshme, abuzimi me alkoolin etj., të cilat vënë në pikëpyetje përshtatshmërinë për punë;
- g) Aftësisë: vëmendja dhe përqendrimi, kujtesa, perceptimi, arsyetimi;
- h) Komunikimi;
- i) Psikomotorike: koha e reagimit, koordinimi i duarve.

Qëllimi i vizitave profesionale psikologjike është për të marrë pjesë në emërimin dhe menaxhimin e stafit. Në caktimin e përmbajtjes së vlerësimit psikologjik, vizita duhet të vlerësojë që punëtori kërkues të mos ketë deficite të konstatuara profesionale psikologjike, veçanërisht në aftësitë operationale ose ndonjë faktor përkatës personaliteti që mundë të ndërhyjë në ushtrimin e sigurt të detyrave.

18.2. Kontrolli periodik pas emërimit/përzgjedhjes (shpeshësia)

- a) Ekzaminimi mjekësor (përshtatshmëria fizike) duhet të bëhet së paku çdo tri (3) vite deri në moshën 55 vjeçare, pas kësaj moshe çdo vit (për Makinistin). Ndërsa për Frenues – Manovruesin çdo vjet,
- b) Përveç kësaj shpeshësie kohore, doktori i akredituar ose i njohur duhet të rrisë shpeshësinë e kontroleve mjekësore nëse gjendja shëndetësore e punëtorit e kërkon;
- c) Një ekzaminim mjekësor i përshtatshëm duhet të kryhet kur ka arsye për të dyshuar se një mbajtës i licencës ose certifikatës nuk i plotëson kushtet e parapara;
- d) Përshtatshmëria fizike duhet të kontrollohet rregullisht dhe pas ndonjë aksidenti që përfshin persona. Mjeku i akredituar ose i njohur mund të vendose për të kryer një ekzaminim shtesë mjekësor, sidomos pas një periudhe të pushimit mjekësor prej së paku 30 ditësh. Punëdhënësi duhet të pyes doktorin mjekësor të akredituar ose të njohur për të kontrolluar përshtatshmërinë fizike të punëtorit nëse punëdhënësi duhet të heqë punëtorin nga shërbimi për arsye sigurie.

18.3. Përmbajtja minimale e ekzaminimit mjekësor periodik

18.3.1 Në qoftë se punëtori përmbush kriteret e kërkuara për ekzaminimin i cili është kryer para emërimit, kontrollat periodike duhet të përfshijnë së paku (minimum):

- a) Kontroll të përgjithshme mjekësore;
- b) Kontroll të funksioneve shqisore (shikimin, të dëgjuarit, perceptimin e ngjyrave);
- c) Testin e gjakut apo urinës për të verifikuar diabetin mellitus dhe kushtet e tjera siç tregohet nga ekzaminimi klinik;
- d) Testet e drogës kur klinikisht vërehet.

Neni 19

19.1. Verifikimi i aftësisë shëndetësore të punonjësve të Trainkos Sh.A. bëhet me kontrollin e jashtëzakonshëm shëndetësor dhe mund të kryhet edhe para skadimit të afateve nga neni 20 i kësaj rregulloreje në këto raste :

- a) Para sistemimit të punonjësit në punët për të cilët kërkohet grupi më i lartë shëndetësor, nga grupi i cili është parashikuar për kryerjen e punëve të cilat punonjësi i ka kryer deri më tani;
- b) Pas çfarëdo paaftësie të përkohshme për punë, për shkak të sëmundjes ose lëndimit i cili ka zgjatë më shumë se 60 ditë;
- c) Nëse ekziston dyshimi i bazuar për marrjen e alkoolit, drogës dhe barërave psikike aktive;
- d) Adaptimi i rënduar profesional i punonjësit në punë;
- e) Pas lëndimit të rëndë të punonjësit;
- f) Pas çdo aksidenti të cilin e ka shkaktuar punonjësi me fajin e vet;
- g) Nëse ndërprerja e punës në punët nga neni 4 i kësaj rregulloreje ka zgjatë më shumë se 6 muaj pa ndërprerje;
- h) Me kërkesë personale të punonjësit;
- i) Nëse ekziston dyshimi i bazuar se punonjësi nuk i plotëson kushtet e veçanta shëndetësore për kryerjen e punëve të caktuara.

Neni 20

Nëse me këtë rregullore nuk është përcaktuar ndryshe, punonjësi i Trainkos Sh.A., i cili gjatë kontrollimit paraprak shëndetësor është sistemuar në grupin adekuat shëndetësor, mund të qëndrojë në punët e kategorisë së caktuar nëse gjatë kontrollimit periodik ose atij të jashtëzakonshëm konstatohet se në aspektin e gjendjes së përgjithshme shëndetësore, aftësive psikike, dëgjimit, shikimit me njohjen e ngjyrave i plotëson kushtet e veçanta shëndetësore të cilat janë konstatuar gjatë sistemimit në grupin e caktuar shëndetësor.

Neni 21

Punonjësi i Trainkos Sh.A., i cili kryen punët e kategorisë së dytë, gjatë kontrollimit paraprak shëndetësor, në aspektin e gjendjes së përgjithshme shëndetësore është sistemuar në grupin e parë shëndetësor mund të qëndrojë në punët e kësaj kategorie nëse gjatë kontrollimit shëndetësor

periodik ose të jashtëzakonshëm konstatohet se në aspektin e gjendjes së përgjithshme shëndetësore i plotëson kushtet shëndetësore të parashikuara për grupin e dytë shëndetësor.

Neni 22

Punonjësi i Trainkos Sh.A., i cili kryen punët e kategorisë së tretë, gjatë kontrollimit paraprak shëndetësor, në aspektin e gjendjes së përgjithshme shëndetësore është sistemuar në grupin e dytë shëndetësor mund të qëndrojë në punët e kësaj kategorie nëse gjatë kontrollimit shëndetësor periodik ose të jashtëzakonshëm konstatohet se në aspektin e gjendjes së përgjithshme shëndetësore i plotëson kushtet e parashikuara për grupin e tretë shëndetësor.

Neni 23

23.1. Punonjësi i Trainkos Sh.A., i cili kryen punët e kategorisë së parë, gjatë kontrollimit paraprak shëndetësor në aspektin e gjendjes së dëgjimit është sistemuar në grupin e parë shëndetësor mund të qëndrojë në punët e kësaj kategorie nëse gjatë kontrollimit shëndetësor periodik ose të jashtëzakonshëm konstatohet se në aspektin e gjendjes së dëgjimit i plotëson kushtet e parashikuara për grupin e dytë shëndetësor.

23.2. Punonjësi i Trainkos Sh.A., i cili kryen punët e kategorisë së tretë, gjatë kontrollimit paraprak shëndetësor në aspektin e gjendjes së dëgjimit është sistemuar në grupin e tretë shëndetësor mund të qëndrojë në punët e kësaj kategorie nëse gjatë kontrollimit shëndetësor periodik ose të jashtëzakonshëm konstatohet se në aspektin e gjendjes së dëgjimit i plotëson kushtet e parashikuara për grupin e tretë shëndetësor.

Neni 24

24.1. Punonjësi i Trainkos Sh.A., i cili kryen punët e kategorisë së parë ose të dytë, te i cili gjatë kontrollimit shëndetësor paraprak, në aspektin e gjendjes së shikimit dhe njohjes së ngjyrave është sistemuar në grupin e parë shëndetësorë, mund të qëndrojë në punët e kësaj kategorie nëse gjatë kontrollimit shëndetësorë periodik ose të jashtëzakonshëm konstatohet se në aspektin e gjendjes së shikimit dhe njohjes së ngjyrave i plotëson kushtet e parashikuara për grupin e dytë shëndetësor.

24.2. Punonjësi i Trainkos Sh.A., i cili kryen punët e kategorisë së tretë, i cili gjatë kontrollimit paraprak shëndetësorë në aspektin e gjendjes së shikimit dhe njohjes së ngjyrave është sistemuar në grupin e parë shëndetësorë, mund të qëndrojë në punët e kësaj kategorie nëse gjatë kontrollimit shëndetësor periodik ose të jashtëzakonshëm konstatohet se në aspektin e gjendjes së shikimit dhe njohjes së ngjyrave i plotëson kushtet e parashikuara për grupin e tretë shëndetësor.

KREU VI

MËNYRA E PËRCAKTIMIT TË KUSHTEVE TË VEÇANTA SHËNDETËSORE DHE VERIFIKIMI I AFTËSISË SHËNDETËSORE TË PUNONJËSVE TË TRAINKOS SH.A.

Neni 25

25.1 Përcaktimin e punonjësve, për dërgim në kontrollimin shëndetësor paraprak, periodik dhe të jashtëzakonshëm, të parashikuar me këtë rregullore e bënë Trainkos Sh.A. Kontrollimin shëndetësor e bënë institucioni shëndetësor i specializuar, të cilin e kontraktin Ndërmarrja Trainkos Sh.A., duke u bazuar në nenin 4 të kësaj Rregulloreje.

25.2 Trainkos Sh.A, kur dërgon punonjësit në kontrollim shëndetësorë është e obliguar që institucionit të specializuar shëndetësor t'i ofrojë në dispozicion të dhënat e nevojshme për llojin e punëve të cilat do t'i kryejnë punonjësit për të cilët kërkohet kontrollimi shëndetësor.

25.3 Nëse punonjësi dërgohet në kontrollim të jashtëzakonshëm shëndetësor, Ndërmarrja është e obliguar që në kërkesë për kryerjen e këtij kontrollimi të tregojë shkaqet për dërgim në pajtim me nenin 21 të kësaj Rregulloreje.

Neni 26

Trainkos Sh.A. punonjësin e vet duhet ta dërgojë në kontrollim shëndetësor periodik më së paku 30 ditë para skadimit të afatit të parashikuar në nenin 20 të kësaj Rregulloreje.

Neni 27

27.1 Në kontrollimin paraprak periodik ose të jashtëzakonshëm nuk mund të dërgohet punonjësi i Trainkos Sh.A. nëse përkohësisht është i paaftë për punë përderisa zgjatë kjo paaftësi.

27.2 Punonjësit e Trainkos Sh.A. të cilët dërgohen në kontrollimin shëndetësor paraprak periodik ose të jashtëzakonshëm duhet siguruar më së paku 12 orë pushim para fillimit të kontrollimit.

Neni 28

Kontrollimi shëndetësor, i cili kryhet për të përcaktuar aftësitë shëndetësore të punonjësve të Trainkos Sh.A. përfshin përcaktimin e kushteve të veçanta shëndetësore të cilat janë të parapara me këtë Rregullore për kryerjen e punëve të caktuara.

Neni 29

29.1. Kontrollimi shëndetësor paraprak, periodik dhe i jashtëzakonshëm përfshin anamnezën profesionale, personale, familjare dhe sociale të punonjësit, kontrollimin fizikal, radiografia e mushkërive, analizat laboratorike, përcaktimin e statusit psikik, testet e diagnostikimit, kontrollimet specialistike të cilat kryhen varësisht nga kategoria e punëve, përcaktimi i gjendjes shëndetësore dhe shkaqet e dërgimit të punonjësit të Trainkos Sh.A., në kontrollim shëndetësor si dhe kontrollimet tjera të cilat janë të nevojshme për vlerësimin e drejtë të aftësisë shëndetësore të punonjësit.

29.2. Në aspektin e vlerësimit të aftësisë psikike të punonjësit të Trainkos Sh.A., kontrollimet

shëndetësore paraprake dhe të jashtëzakonshme përfshijnë kontrollimet të cilat janë të nevojshme për vlerësimin e aftësisë intelektuale psikomotorike, vetitë e personalitetit, mbajtjen në mend, shpejtësinë mendore, shpejtësinë e zgjedhjes së reaksionit dhe stabilitetit emocional.

Neni 30

Në bazë të shikimit të rezultateve pas kryerjes së kontrollit, të dhënave mjekësore dhe dokumentacionit në dispozicion, institucioni i specializuar shëndetësor që ka kryer kontrollimin shëndetësor jep vlerësimin për plotësimin e kushteve të veçanta gjegjësisht për aftësinë shëndetësore të punonjësit të Trainkos Sh.A., për kryerjen e punëve të parashikuara në nenin 4 të kësaj Rregulloreje.

Neni 31

31.1. Për rezultatet e kontrollit dhe të vlerësimit të aftësisë shëndetësore, institucioni i specializuar shëndetësor me shkrim njofton Trainkos Sh.A. për punonjësin që e ka dërguar në kontrollim shëndetësor.

31.2. Nëse gjatë kontrollimit shëndetësor konstatohet se punonjësi i Trainkos Sh.A. nuk i plotëson kushtet e parashikuara të veçanta shëndetësore institucioni i specializuar shëndetësor është i obliguar që për këtë menjëherë ta njoftojë Trainkos Sh.A.

Neni 32

32.1. Në vlerësimin e aftësisë shëndetësore të punonjësit të Trainkos Sh.A., institucioni i specializuar shëndetësor është i obliguar të theksojë se me kontrollimin e kryer shëndetësor është konstatuar se punonjësi në aspektin shëndetësor është i aftë për kryerjen e punëve të caktuara.

32.2. Nëse me kontrollimin shëndetësor konstatohet se punonjësi i Trainkos Sh.A., nuk i plotëson kushtet e veçanta shëndetësore të parashikuara me këtë Rregullore, në vlerësimin e aftësisë shëndetësore theksohet se punonjësi është përkohësisht ose përjetësisht i paaftë për kryerjen e punëve të caktuara.

Neni 33

Kryerjen e kontrollimeve shëndetësore të parashikuara me këtë Rregullore Trainkos Sh.A. ia beson institucionit të specializuar për kontrollime shëndetësore për të cilin është konstatuar se i plotëson kushtet për kryerjen e kontrollimeve shëndetësore në pajtim me nenin 3 të kësaj Rregulloreje.

Neni 34

34.1 Institucioni i specializuar shëndetësor, i cili kryen kontrollimet shëndetësore në pajtim me këtë Rregullore, është i obliguar:

- a) Të udhëheqë evidencën dhe të ruajë dokumentacionin mbi kontrollimet e kryera shëndetësore;
- b) Institucioni i specializuar shëndetësor, për Trainkos Sh.A, përgatitë raportin vjetor mbi kontrollimet e kryera shëndetësore, konstatimet dhe vlerësimet e aftësisë shëndetësore për

punonjësit e kontrolluar;

c) Në rast të ndërprerjes kontratës për kryerjen e kontrollimeve shëndetësore për punonjësit e Trainkos Sh.A., institucioni i specializuar shëndetësor obligohet që tërë dokumentacionin shëndetësor për kontrollimet shëndetësore paraprake, periodike dhe të jashtëzakonshme të kryera më herët t'ia dorëzojë institucionit tjetër të specializuar shëndetësor, i cili është kontraktuar nga Trainkos Sh.A., për kryerjen e këtyre kontrollimeve.

Neni 35

35.1 Trainkos Sh.A., për punët që kryhen sipas parashikimeve në nenin 4 të kësaj Rregulloreje, është e obliguar:

- a) Të udhëheqë regjistrin e punëve dhe punonjësve të cilët drejtpërdrejtë marrin pjesë në organizimin e komunikacionit hekurudhor;
- b) Të udhëheqë librin e afateve të kontrollimeve shëndetësore periodike për punonjësit e punësuar;
- c) Institucionit të specializuar shëndetësor, të cilit ia ka besuar kryerjen e kontrollimeve shëndetësore, i ofron të dhënat mbi procesin dhe kushtet e punës së punëtorëve, të cilët në pajtim me këtë Rregullore i nënshtrohen kontrollimit shëndetësor.

KREU VII

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTATRE

Neni 36

Kontrollimet shëndetësore paraprake, periodike dhe të jashtëzakonshme të punonjësve të Trainkos Sh.A. të cilat kanë filluar para futjes në fuqi të kësaj Rregulloreje do t'i kryejnë në mënyrën e parashikuar me rregulloren mbi kushtet e veçanta shëndetësore të përbashkëta identike dhe psikologjike për punonjësit e Trainkos Sh.A. të cilët drejtpërdrejtë marrin pjesë në organizimin e komunikacionit hekurudhor.

Neni 37

Afatet nga neni 20 i kësaj rregulloreje llogariten prej ditës kur është kryer kontrollimi i fundit periodik shëndetësor i punonjësve të Trainkos-it, në bazë të rregullave të cilat kanë qenë në fuqi deri në futjen e kësaj rregulloreje në fuqi.

Neni 38

Kontrollimet shëndetësore periodike të punonjësve të Trainkos Sh.A. të cilët punojnë në punët të cilat deri në ditën e futjes në fuqi të kësaj Rregulloreje nuk kanë qenë të përcaktuara si punë në të cilat punonjësit drejtpërdrejtë marrin pjesë në organizimin e komunikacionit hekurudhor do të kryhen në afat prej një viti nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje.

Neni 39

Kjo Rregullore hyn në fuqi pas aprovimit nga Bordi i Drejtorëve dhe nënshkrimit nga Kryesuesii Bordit të Drejtorëve i Hekurudhave të Kosovës –Trainkos Sh.A.

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje shfuqizohet Rregullorja mbi Kushtet Shëndetësore të Punonjësve, numër protokollit I/146, të datës 30.06.2015.

 **Jetmir NUKA**
Kryesues i Bordit të Drejtorëve